VENDIM
Nr. 44, datë 16.7.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	"	"
Vitore Tusha	anëtare e	"	"
Altina Xhoxhaj	anëtare e	"	"
Fatmir Hoxha	anëtar i	"	"
Gani Dizdari	anëtar i	"	"
Sokol Berberi	anëtar i	"	"

me sekretare Edmira Babaj, në datën 24.4.2014 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 15 Akti, që i përket:

KËRKUES:Avokatura e Përgjithshme e Shtetit

SUBJEKT I INTERESUAR: Dhimitraq Lapa

OBJEKTI: Shfuqizimi, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimeve nr. 23-2011-571 (377), datë 25.3.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë; nr. 31, datë 27.1.2012, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër dhe nr. 00-2013-628 (127), datë 14.2.2013, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberi, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueses, e cila është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, që kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe, pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr. 17, datë 9.6.1994 (*në vijim nr. 17/1994*) të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) Sarandë u është njohur ish – pronarëve pronësia mbi një sipërfaqe toke prej 65.5 ha, të ndodhur në Sarandë. Një pjesë e kësaj sipërfaqeje, prej 25.000 m^2, u është kthyer ish-pronarëve në natyrë. Subjekti i interesuar është një nga trashëgimtarët ligjorë të njërit prej ish – pronarëve, A.L.

2. Vendimi nr. 17/1994 i KKKP-së është kundërshtuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë pasi sipas paditësve, në cilësinë e ish-pronarëve, me ndryshimin e legjislacionit për kthimin dhe kompensimin e pronës, atyre u takonte kthimi i sipërfaqeve deri në 10.000 m^2 për person. Kjo gjykatë me vendimin nr. 137, datë 18.3.1999 ka vendosur kthimin e sipërfaqes së truallit prej 12.500 m^2 që rezultoi e lirë nga verifikimet e ekspertit dhe e përfshirë në sipërfaqen e kthyer paditësve.

3. Sipas shkresës nr. 1456/2 prot., datë 23.4.2010, të ZRPP-së drejtuar ZVRPP-së Sarandë, rezulton se nga verifikimet e bëra sipas kufijve të përcaktuar në vendimin nr. 17/1994 të KKKP-së Sarandë, sipërfaqja del 37.120 m^2 dhe jo 25.000 m^2. Gjithashtu, në këtë shkresë evidentohet se duke krahasuar planimetrinë bashkëlidhur vendimit gjyqësor nr. 137/1999 me atë bashkëlidhur vendimit nr. 17/1994 të KKKP-së sipërfaqet e kthyer me vendimin gjyqësor dalin më të mëdha se në dokumentin ligjor. Për këto arsye, ZRPP-ja ka kufizuar veprimet deri në përcaktimin e sipërfaqes nga ana hartografike.

4. Duke pretenduar se brenda sipërfaqes së përgjithshme ka ende sipërfaqe të lira, subjekti i interesuar i është drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, e cila me vendimin nr. 23-2011-571 (377), datë 25.3.2011 ka vendosur pranimin e padisë dhe kthimin në pronësi të një sipërfaqeje prej 7690 m^2 sipas vendndodhjes, kufizimeve dhe pozicionit hartografik të përcaktuar në planvendosjen që shoqëron vendimin nr. 17/1994 të KKKP dhe aktin e ekspertimit depozituar në dosje.

5. Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr. 31, datë 27.01.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbi rekursin e kërkueses, me vendimin nr. 00-2013-628 (127), datë 14.2.2013, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit.

II

7. ***Kërkuesja****,* i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar se vendimet gjyqësore, objekt kërkese, janë rezultat i një procesi të parregullt ligjor. Më konkretisht ajo pretendon se është cenuar:

7.1 E drejta për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, si dhe parimi i kontradiktoritetit pasi nuk është njoftuar nga gjykata e shkallës së parë për t'u paraqitur në gjykim. Gjithashtu kërkuesja nuk është njoftuar për aktin e ekspertimit, provë kryesore e cila nuk është debatuar, në cenim të parimit të kontradiktoritetit;

7.2 Parimi i gjykatës së caktuar me ligj për arsye se gjykata e shkallës së parë nuk kishte kompetencë territoriale për të gjykuar çështjen. Subjekti i interesuar ka ngritur padinë si një padi administrative kundër një personi juridik publik ndaj në zbatim të dispozitave procedurale civile (neni 43) padia duhej ngritur në gjykatën kompetente të territorit ku ndodhet selia e palës së paditur (AKKP);

7.3 Parimi i sigurisë juridike pasi vendimi nr. 17/1994 i KKKP-së Sarandë është bërë më parë objekt i shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Shkallës së Parë Sarandë me vendimin e së cilës bien ndesh vendimet, objekt kërkese. Prona ka mbivendosje me një pronar tjetër i cili nuk është thirrur nga gjykata si palë ndërgjyqëse.

8. ***Subjekti i interesuar****,* ka prapësuar si vijon:

8.1 Pretendimi i kërkueses se nuk është njoftuar të marrë pjesë në gjykim është i pambështetur. Saktësimi i planvendosjes sipas matjeve të sakta brenda pronës kur palët janë përcaktuar dhe shteti ka liruar pronën në favor të tyre e bën të panevojshme thirrjen e kërkueses, pasi në këtë rast nuk kemi të bëjmë me një disponim të ri të kalimit të pronësisë së shtetit te ish-pronarët;

8.2 Për sa i përket pretendimit të cenimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj ky pretendim nuk qëndron pasi mosmarrëveshja konkrete lidhet me të drejta reale mbi sende të paluajtshme me vendndodhje në qytetin e Sarandës. Meqenëse rezulton ndërgjyqësia me dy palë të paditura, sipas neneve 53 dhe 54 të Kodit të Procedurës Civile padia mund të ngrihet në vendbanimin ose vendqëndrimin e cilitdo prej të padituve dhe e drejta e zgjedhjes i takon paditësit;

8.3 Argumentet e kërkueses për cenimin e parimit të sigurisë juridike nuk janë të mbështetura pasi ajo nuk mbron interesat e shtetit në rastin konkret por të një subjekti privat (M.Z.). Mosmarrëveshja me këtë subjekt privat nuk ka lidhje me planvendosjen e truallit që përfitojnë subjektet e interesuara nëpërmjet saktësimit të sipërfaqes me vendimet gjyqësore që janë objekt i kësaj kërkese.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u dëgjuar, për t'u mbrojtur, si dhe parimit të kontradiktoritetit

9. Kërkuesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar, për t'u mbrojtur, si dhe të parimit të kontradiktoritetit pasi nuk është njoftuar nga gjykata e shkallës së parë për t'u paraqitur në gjykim, në shkelje të nenit 79/a të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Në cenim të parimit të kontradiktoritetit, akti i ekspertimit, si provë kryesore, nuk i është njoftuar as kërkueses as AKKP-ja (palë e paditur në gjykim), të cilat nuk kanë pasur mundësi të debatojnë mbi të.

10. Gjykata, në jurisprudencën e saj është shprehur se e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshme të individit. E drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi, për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjake, në raport me palën kundërshtare. Ajo i paraprin të drejtave të tjera, pasi, nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor *(shih vendimet nr. 18, datë 23.4.2013; nr. 34, datë 25.7.2011 dhe nr. 34 datë 3.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese)*.

11. Parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit kërkon që secilës palë në gjykim t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur pretendimet e veta sipas kushteve, të cilat nuk e vendosin në disavantazh ndaj kundërshtarit. Secila palë duhet të ketë mundësi që të komentojë mbi të gjitha provat ose parashtrimet e paraqitura, me qëllim që të ndikojë në vendimmarrjen e gjykatës (*shih vendimin nr. 4, datë 23.2.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Sipas ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit" dhe ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit" (nr. 10018/2008), asistenca juridike e kërkueses është e detyrueshme për institucionet dhe për çështjet juridike të përcaktuara në nenin 5 të ligjit nr. 10018/2008. Ajo përfaqëson dhe

mbron interesat pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave kombëtare, ndërkombëtare dhe të huaja, pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit në çështjet gjyqësore, në të cilat një organ i administratës shtetërore ose Republika e Shqipërisë është palë (neni 2 dhe 5 i ligjit nr. 10018/2008 *supra).*

13. Gjykata ka theksuar se gjykimi kushtetues synon të vlerësojë nëse procesi, si i tërë, ka qenë i rregullt, duke u ndalur në ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të palëve në proces *(shih vendimin nr. 5, datë 25.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese).*

14. Nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se AKKP-ja është lajmëruar për gjykimin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, çka rezulton nga fletëthirrjet e datave 17.3.2011; 3.3.2011; 16.2.2011; 17.1.2011, të vulosura nga marrësi. Po kështu, në dosje gjendet e administruar shkresa me anë të së cilës gjykata njofton kërkuesen për zhvillimin e gjykimit (shkresa e datës 26.1.2011). Për pasojë, Gjykata konstaton se, në shkallë të parë, gjykata e ka përmbushur detyrimin e njoftimit të AKKP dhe kërkueses, të cilat pa shkaqe të arsyeshme nuk janë paraqitur në gjykim.

15. Gjithashtu, në rastin në shqyrtim, rezulton se si AKKP ashtu edhe kërkuesja kanë qenë të pranishme gjatë gjykimit në apel dhe kanë ushtruar të drejtën e mbrojtjes, në kushtet e kontradiktoritetit, siç shihet qartë nga procesverbalet e seancave gjyqësore të datave 5.7.2011; 24.10.2011; 27.1.2011.

16. Në këto kushte, për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimet e kërkueses për sa i përket cenimit të së drejtës për t'u dëgjuar, së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të kontradiktoritetit, janë të pabazuara.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të gjykatës së caktuar me ligj

17. Kërkuesja ka pretenduar cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj për arsye se gjykata e shkallës së parë nuk kishte kompetencë territoriale për të gjykuar çështjen. Subjekti i interesuar ka ngritur padinë si një padi administrative kundër një personi juridik publik ndaj në zbatim të dispozitave procedurale civile (neni 43) padia duhej ngritur në gjykatën kompetente të territorit ku ndodhet selia e palës së paditur (AKKP), pra në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

18. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata sqaron, se çështjen e kompetencës ajo e ka vlerësuar të lidhur me standardin kushtetues të "*gjykatës së krijuar me ligj*", element ky i procesit të rregullt ligjor dhe i parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Përcaktimi i saktë i kompetencës është detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës, sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës sipas së cilit, e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit (*shih vendimin nr. 27, datë 27.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Termi "*gjykatë*" karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në një proces të zhvilluar mbi një procedurë ligjërisht të përcaktuar dhe në pajtim me shtetin e së drejtës. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit *(shih vendimet nr. 27, datë 24.6.2013; nr. 22, datë 22.7.2009 dhe nr. 31, datë 1.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese).*

20. Kuptimi i kompetencës si kufi i juridiksionit lind nga shumëllojshmëria e organeve që ushtrojnë këtë juridiksion, të parashikuara nga rendi juridik, si dhe nga kërkesa që rrjedh prej këtij të fundit për të ndarë këtë pushtet midis organeve shtetërore. Në këtë kuadër, kompetenca e gjyqtarit është kufiri i fundit që përcakton fushën e juridiksionit brenda të cilit ai është i detyruar që të procedojë për zgjidhjen e një çështjeje të caktuar (*shih vendimin nr. 11, datë 23.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese).*

21. Në rastin konkret, pretendimin për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj kërkuesja e ka lidhur me mosrespektimin e kompetencës tokësore nga gjykata. Në vështrim të dispozitave procedurale përkatëse që rregullojnë kompetencën tokësore të gjykatës, bazuar në nenet 42 dhe 43 të KPC, "*Paditë ngrihen në gjykatën e vendit ku i padituri ka vendbanimin ose vendqëndrimin e tij"…. "Kur i padituri është person juridik, paditë ngrihen në gjykatën e vendit ku personi juridik ka qendrën e tij*". Ndërkaq, referuar neneve 53 dhe 54 të KPC, "*Kur janë shumë të paditur, që kanë banimin ose vendqëndrimin e tyre në vende të ndryshme, padia mund të ngrihet në gjykatën e vendit ku ka banimin ose vendqëndrimin cilido nga të padituri*".... "*E drejta e zgjedhjes ndërmjet shumë gjykatave kompetente i takon paditësit, e cila ushtrohet me ngritjen e padisë*". Sipas ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", në fuqi në kohën e ngritjes së padisë, "*kundër vendimit të AKKP-së subjekti i shpronësuar ose Avokati i Shtetit ka të drejtë të bëjë ankim (...) pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë"* (neni 18 i ligjit).

22. Në rastin konkret, Gjykata e Apelit Gjirokastër është shprehur se, bazuar në nenin 4 të KPC, Gjykata e

Rrethit Gjyqësor Sarandë është gjykata kompetente nga ana lëndore për të shqyrtuar çështjen. Më tej, kjo gjykatë ka arsyetuar se nuk qëndron pretendimi i ngritur për kompetencën tokësore pasi në rastin konkret bëhet fjalë për një të drejtë reale mbi sende të paluajtshme dhe të drejtën e zgjedhjes e ka paditësi që investon gjykatën (*f. 5 e vendimit*). Gjykata e Lartë ka arsyetuar se pretendimet e paraqitura në rekurs (ku përfshihet edhe pretendimi në lidhje me mosrespektimin e kompetencës tokësore) janë ato që janë paraqitur edhe në gjykatën e apelit të cilat janë analizuar nga kjo gjykatë dhe ju është dhënë përgjigje. Ato janë gjetur të pabazuara duke ju referuar provave të administruara dhe frymës së ligjit (*fq. 3-4 të vendimit*). Në vijim të konstatimeve të mësipërme, Gjykata çmon se gjykatat e zakonshme janë shprehur në lidhje me pretendimin e mosrespektimit të kompetencës tokësore, të cilin e kanë gjetur të pambështetur, bazuar në dispozitat përkatëse të KPC, të lartpërmendura.

23. Gjykata ka pranuar se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në aspektin kushtetues dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është të vlerësojë nëse procesi si i tërë, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ka qenë i drejtë *(shih vendimet nr. 40, datë 22.9.2011 dhe nr. 21, datë 1.10.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Nga rrethanat e çështjes në shqyrtim, Gjykata vlerëson se për sa i përket cenimit të kompetencës tokësore, kërkuesja nuk ka parashtruar argumente bindëse në drejtim të natyrës thelbësore të kësaj shkeljeje, ndikimit të drejtpërdrejtë që kjo shkelje ka në procesin ligjor apo cenimit në thelb të të drejtave të saj kushtetuese. Duke e vlerësuar procesin në tërësi, Gjykata çmon se, pretendimi i kërkueses për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj dhe kërkesa për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore, objekt shqyrtimi, mbështetur mbi këtë pretendim, janë të pabazuara.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike

25. Kërkuesja ka pretenduar gjithashtu cenimin e parimit të sigurisë juridike pasi vendimi i KKKP-së Sarandë është bërë më parë objekt i shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë (vendimi nr. 137/1999). Vendimet, objekt kërkese, sipas saj, bien ndesh me vendimin e mëparshëm nr. 137/1999. Nuk është krijuar drejt ndërgjyqësia pasi për këto prona ekziston mbivendosje për zgjidhjen e së cilës ka qenë duke u zhvilluar një gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

26. Gjykata e ka theksuar vazhdimisht në jurisprudencën e saj rëndësinë e parimit të sigurisë juridike si një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës. Parimi i shtetit të së drejtës ku mbështetet një shtet demokratik, nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike. Siguria juridike, përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin tek sistemi juridik (*shih vendimet nr. 37, datë 13.6.2012 dhe nr. 20, datë 11.7.2006 të Gjykatës Kushtetuese).*

27. Edhe në lidhje me parimin *res judicata*, Gjykata ka vlerësuar se vendimi gjyqësor i formës së prerë, që përbën gjë të gjykuar, është shprehje dhe konkretizim i së drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t'i japë jo vetëm qartësi, por dhe siguri kësaj marrëdhënieje. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike. Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin (*shih vendimet nr. 15, datë 19.4.2013 dhe nr. 23, datë 8.6.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu Gjykata është shprehur se kufijtë e zbatimit të parimit të gjësë së gjykuar përcaktohen në lidhje të ngushtë me thelbin e mosmarrëveshjes në gjykim. Në këtë aspekt, Gjykata Kushtetuese çmon se gjëja e gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por dhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit me kusht, që të jenë kryer me qëllim të dhënies së vendimit gjyqësor dhe t'i përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj (*shih vendimin nr. 24, datë 12.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese).*

28. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, rezulton se vendimi nr. 137/1999 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, ka për objekt kundërshtimin e vendimit nr. 17/1994 të KKKP-it. Në këtë vendim gjykata ka vendosur që, ish pronarëve, përveç sipërfaqes së kthyer prej 25,000 m^2, t'u kthehen edhe 12,500 m^2 sipërfaqe e lirë, sipas kufijve përkatës, që përfshihet brenda sipërfaqes totale të kthyer me vendimin nr. 17/1994 të KKKP-së.

29. Vendimi nr. 377/2011 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, ka një objekt të ndryshëm nga vendimi nr. 137/1999, konkretisht: deklarimin e pasaktësisë së pjesshme të vendimit nr. 17/1994 të KKKP-së në lidhje me

kthimin e sipërfaqeve të lira të kthyera brenda sipërfaqes së përgjithshme sipas planvendosjes së këtij vendimi dhe vendimit nr. 137/1999, në raport me gjendjen në terren, duke u kthyer sipërfaqet aktualisht të lira, përshtatjen e pronës në terren në bazë të koordinatave topografike të vlefshme për regjistrim në ZRPP. Me këtë vendim, gjykata ka vendosur saktësimin e vendimit nr. 17/1994 të KKKP-së dhe kthimin e një sipërfaqeje të lirë prej 7960 m^2 në qytetin e Sarandës sipas vendndodhjes, kufizimeve dhe pozicionit hartografik të përcaktuar në planvendosjen që shoqëron vendimin nr. 17/1994 dhe aktin e ekspertimit. Në dispozitivin e këtij vendimi nuk janë përcaktuar konkretisht kufijtë përkatës të sipërfaqes së kthyer prej 7960 m^2 dhe as pjesët takuese për secilin ish-pronar.

30. Në vlerësimin e Gjykatës paqartësia në pjesën urdhëruese të vendimit mund të korrigjohet me mjete të tjera juridike. Kështu sipas nenit 312 të KPC, pas shpalljes së vendimit me kërkesën e palëve ose kryesisht, gjykata mund të ndreqë në çdo kohë vetëm gabimet e bëra në shkrim ose në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të vendimit. Gjithashtu, edhe në bazë të nenit 314 të KPC, gjykata ka të drejtë të japë sqarime ose të bëjë interpretimin e vendimit që ajo ka dhënë kur ky është i errët dhe e kërkojnë palët. Për pasojë edhe saktësimi i dispozitivit mund të bëhet me kërkesë të palëve mbi të cilën gjykata vendos duke bërë ndryshimet ose interpretimet përkatëse. Në vijim të arsyetimit të mësipërm, Gjykata e gjen të pabazuar pretendimin e kërkueses për cenimin e parimit të sigurisë juridike.

31. Si përfundim, për sa më lart, Gjykata çmon se pretendimet e kërkueses, për cenim të procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ, janë të pabazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Sokol Berberi, Gani Dizdari